

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“RHE” SHPK

Sot, më datë 17.02.2025, ortaku si më poshtë:

1. **Z. Endrit Mertiraj**, shtetas shqiptar, lindur me 24.04.1985, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit nr. 038033198 dhe nr. personal I50424074T;

Vendosën të hartojnë këtë Akt Themelimi, me përmbajtje si më poshtë:

NENI 1
DATA E THEMELIT

Sot, më datë 17.02.2025, themeluesi **Endrit Mertiraj** endosi të krijojë një shoqëri me emërtimin “RHE” SHPK.

NENI 2
FORMA E SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

NENI 3
EMËRTIMI

Emri i plotë i shoqërisë është “RHE” shpk.

NENI 4
SELIA

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga "Themistokli Gwrmënji", Pallati Ambasador 1, Kati i 12, Tiranë, Albania.

Me miratim të organeve të saj, shoqëria mund të ndryshojë selinë, mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

NENI 5
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së



Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria “RHE” shpk do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Ofron: 1. **Shitje dhe blerje të pasurive të patundshme:** Aktiviteti i blerjes, shitjes dhe transferimit të pronave të patundshme për qëllime tregtare, komerciale, industriale dhe banimi, përfshirë shërbime për klientët në lidhje me vlerësimin, negocimin dhe përgatitjen e dokumentacionit ligjor për transaksionet e pasurive të patundshme. 2. **Menaxhimi i pasurive të patundshme:** Ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të pasurive të patundshme, duke përfshirë administrimin e pasurive të patundshme për llogari të pronarëve, menaxhimin e qirave, dhe sigurimin e shërbimeve të mirëmbajtjes, si dhe kujdesin për të gjitha detyrimet administrative dhe financiare që lidhen me këto pasuri. 3. **Këshillim dhe shërbime për pasuritë e patundshme:** Ofrimi i shërbimeve të këshillimit në lidhje me investimet në pasuri të patundshme, përfshirë analiza të tregut, vlerësimin e pasurive, dhe asistencë në zhvillimin dhe implementimin e strategjive të investimeve të pasurive të patundshme. 4. **Marrëveshje dhe negociata për pasuri të patundshme:** Angazhimi në marrëveshje dhe negociata për blerjen, shitjen dhe huadhënien e pasurive të patundshme, përfshirë lidhjen e kontratave për zhvillim, qira dhe përdorim të pronave. 5. **Hulumtim dhe studime të tregut të pasurive të patundshme:** Zhvillimi dhe realizimi i studimeve të tregut dhe analizave për sektorin e pasurive të patundshme, përfshirë studime të kërkesës dhe ofertës, vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve të investimeve në pasuri të patundshme. 6. **Shërbime të tjera të lidhura me pasuritë e patundshme:** Ofrimi i çdo shërbimi tjetër të lidhur me pasuritë e patundshme që mund të ndihmojë individët, kompanitë dhe organizatat të menaxhojnë pasuritë e tyre në mënyrë efikase dhe të suksesshme.

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, i zotëruar plotësisht nga ortaku si më poshtë:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Vlera e Pjesmarrjes
Endrit Mertiraj	100 %	1	10,000 (Lek)

Ky kapital është i ndarë në 1 (një) kuot e zotëruar nga një ortak.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

NENI 8 ADMINISTRATORI



Administratori i parë i shoqërisë “RHE” shpk do të jetë:

Administrator i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Endrit Mertiraj**, shtetas Shqiptar, lindur më 24.04.1985 në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit nr. 038033198 dhe nr. personal I50424074T.

Kohëzgjatja e mandatit të tij është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9
DISPOZITAT E FUNDIT

Ky akt themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.

Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar, gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.

Autorizohet Administratori **Z. Endrit Mertiraj** për të kryer veprimet e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

THEMELUESIT

ENDRIT MERTIRAJ

